



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE**

Nr. 1024/1 prot.

Tiranë më 26.6.2018

Lënda: Mendim mbi projektudhëzimin që buron si detyrim i ligjit nr.119/2014
“Për të drejtën e informimit”

MINISTRISË SË DREJTËSISË

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 6259/1 Prot., datë 08.06.2018 “Kërkesë për kontribut”, Zyra e Komisionerit e vlerëson shumë të rëndësishëm miratimin e projektudhëzimit “Për përcaktimin e numrit të faqeve për të cilat informacioni përfitohet falas, rastet e përjashtimit nga pagesa e tarifës, si dhe rregulla për mënyrën e kryerjes së pagesës për pajisjen me informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”, jo vetëm si një detyrim që buron nga ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, por edhe për krijimin e një praktike të unifikuar mbi shërbimin që duhet të marrin qytetarët lidhur me përcaktimet mbi informacionin që përfitohet falas si dhe rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës në rastin e dhënies së informacionit me pagesë.

Në tërësi shprehemi dakord me përmbajtjen e tekstit, ndërkohë vlerësojmë që lidhur me pikën 2 të projektudhëzimit, numri i faqeve për informacionin e përfituar falas për qytetarët e regjistruar rregullisht në skemat e ndihmës shoqërore si dhe subjektet përfitues sipas ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, të jetë në çdo rast të paktën **20 faqe** për çdo kërkesë, ose në vlerën ekuivalente kur informacioni jepet në një format tjetër.

Sa i përket pikës 3 të projektudhëzimit, sugjerojmë reformulimin e paragrafit në:
“Personat me aftësi të kufizuar, përjashtohen tërësisht nga pagimi i tarifës për çdo kërkesë për dhënie informacioni nga autoriteti publik përkatës”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

